



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:060919
Datë: 16.09.2024
Numri i dokumentit: 06162369

KPPP.nr. 386/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbarimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Elsig”, me seli në Prishtinë, rr. “Tringë Smajli”, nr. 19, kundër debitorit Toifor Sh.P.K., me numër të biznesit 810484890 dhe seli në Prishtinë, Lagjia Emshir, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 338/23, të datës 07.12.2023, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi nga Prishtina, jashtë seancës me datën 16.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Toifor Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr. 338/23 i datës 07.12.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Elsig”, me datë 07.12.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 338/23, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve; Faturës nr. 0714307 e datës 05.05.2023; Faturës nr. 0714306 e datës 05.05.2023; Faturës nr. 0670080 e datës 15.12.2022; Faturës nr. 0669704 e datës 14.12.2022; Faturës nr. 0666316 e datës 05.12.2022; Faturës nr. 0666310 e datës 05.12.2022; Faturës nr. 0664572 e datës 30.11.2022; Faturës nr. 0663880 e datës 29.11.2022; Faturës nr. 0663874 e datës 29.11.2022; Faturës nr. 0661576 e datës 21.11.2022; Faturës nr. 0657146 e datës 09.11.2022; Faturës nr. 0657144 e datës 09.11.2022; Faturës nr. 0657140 e datës 09.11.2022; Faturës nr. 0657129 e datës 09.11.2022; Faturës nr. 0657126 e datës 09.11.2022; Faturës nr. 0655248 e datës 04.11.2022; Faturës nr. 0648598 e datës 18.10.2022; Faturës nr. 0639717 e datës

22.09.2022; Faturës nr. 0639169 e datës 21.09.2022; Faturës nr. 0633324 e datës 05.09.2022; Faturës nr. 0623592 e datës 08.08.2022; Faturës nr. 0607051 e datës 27.06.2022; Faturës nr. 0590578 e datës 13.05.2022; Faturës nr. 0583812 e datës 21.04.2022 dhe Faturës nr. 0475464 e datës 23.03.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t'ia paguaj kreditorit shumën prej 3,383.67 EUR (tremijë e treqind e tetëdhjetë e tre euro e gjashtëdhjetë e shtatë cent), me kamatë ligjore prej 8 % nga data e faturimit e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhri Përmbartimor, me arsyetimin se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbartimor nuk janë pranuar dhe nënshkruar nga i njëjti, si dhe nuk përmbajnë kohën e përmbushjes së detyrimit monetar pasi që data e lëshimit të faturave nuk mund të jetë e njëjtë me datën e përmbushjes së detyrimit. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet, si dhe të obligohet kreditori që të kompensojë shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetimin se nuk qëndrojnë pretendimet se fatura nuk mund të ketë të njëjtën datë të lëshimit dhe të përmbushjes së detyrimit sepse kjo është kërkesë ligjore, prandaj si e tillë është pranuar nga debitori por që i njëjti nuk ka përmbushur detyrimin ndaj kreditorit. Ka shtuar se debitori ka pranuar dhe nënshkruar faturat, andaj edhe janë dokumente të përshtatshme për përmbartim, duke i përmbajtur të gjitha elementet e dokumentit të besueshëm, sipas nenit 29 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkak që si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së,

përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbardjes së detyrimit monetar*”, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*”.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 0714307, e datës 05.05.2023; Fatura nr. 0714306, e datës 05.05.2023; Fatura nr. 0670080, e datës 15.12.2022; Fatura nr. 0669704, e datës 14.12.2022; Fatura nr. 0666316, e datës 05.12.2022; Fatura nr. 0666310, e datës 05.12.2022; Fatura nr. 0664572, e datës 30.11.2022; Fatura nr. 0663880, e datës 29.11.2022; Fatura nr. 0663874, e datës 29.11.2022; Fatura nr. 0661576, e datës 21.11.2022; Fatura nr. 0657146, e datës 09.11.2022; Fatura nr. 0657144, e datës 09.11.2022; Fatura nr. 0657140, e datës 09.11.2022; Fatura nr. 0657129, e datës 09.11.2022; Fatura nr. 0657126, e datës 09.11.2022; Fatura nr. 0655248, e datës 04.11.2022; Fatura nr. 0648598, e datës 18.10.2022; Fatura nr. 0639717, e datës 22.09.2022; Fatura nr. 0639169, e datës 21.09.2022; Fatura nr. 0633324, e datës 05.09.2022; Fatura nr. 0623592, e datës 08.08.2022; Fatura nr. 0607051, e datës 27.06.2022; Fatura nr. 0590578, e datës 13.05.2022; Fatura nr. 0583812, e datës 21.04.2022; Fatura nr. 0475464, e datës 23.03.2021, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29, par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbardje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbardjes së këtij detyrimi.

Tutje, gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit i cili pasqyrohet tek pranuesi i secilës faturë e po ashtu i janë bashkëngjitur propozimit për përmbardim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbardimit pasi që janë të përshtatshme për përmbardim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbardim nuk përbëjnë dokument të besueshëm pasi që data e lëshimit të faturës dhe afati për pagesë nuk mund të jenë të njëjta por që me vet faktin se debitori ka pranuar faturat e lartcekura dhe ndaj të njëjtave nuk ka pasur asnjë kundërshtim, rezulton se i njëjti është pajtuar me detyrimin dhe afatin e pagesës sipas këtyre faturave.

Andaj, gjykata në rastin konkret gjeti se nuk plotësohen asnjë nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 386/24, datë 16.09.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.